

## C.3 REDAKTUESI I REGJISTRIMIT

Regjistrimet nga baza e të dhënave METADAT i plotësoni në redaktuesin e regjistrimeve në dritaren **Regjistrimi bibliografik**.

Në menunë **Regjistrimi** janë në dispozicion metodat për administrimin e regjistrimeve, siç është redaktimi, shkarkimi, verifikimi automatik, ruajtja e përkohëshme dhe ruajtja e regjistrimit. Metodat, të cilat nuk përdoren gjatë punës me regjistrimet nga baza METADAT, nuk janë aktive.

---

### C.3.1 Administrimi i regjistrimeve

Nga baza e të dhëna METADAT regjistrimet mund t'i shkarkoni në COBIB dhe në bazën lokale të të dhënave. Biblioteka ka në dispozicion vetëm regjistrimet e ofertuesve, me të cilët ka marrëveshje për shkarkimin e tyre.

Regjistrimin e shkarkoni nga baza METADAT përmes metodës **Regjistrimi / Shkarko regjistrimin**, më pas i plotësoni të dhënat dhe regjistrimin e ruani. Nëse përdorni metodën **Regjistrimi / Ruaj regjistrimin përkohësisht**, ndryshimet ruhen vetëm në METADAT. Nëse për ruajtjen e regjistrimit përdorni metodën **Regjistrimi / Ruaj regjistrimin**, regjistrimi ruhet në COBIB dhe në bazën lokale, ndërsa në dritaren **METADAT** regjistrimi më nuk shfaqet.